



Ndeshja me Teutën tashmë është në prag dhe padyshim që në kampin shkodran janë gati për ta kaluar me sukses atë, pavarësisht disa problemeve që Vllaznia ka mungesat e lojtarëve. I këtij mendimi është shfaqur trajneri Armando Cungu në konferencën e sotme për shtyp pikërisht në pragndeshjen e radhës me durrsakët duke kërkuar maksimumin nga çdo futbollist që do të jetë në fushën e lojës. "Kemi pasë disa probleme ditët e fundit si me Bardullën, Pjeshkën e Tafilin por ato po shkojnë drejt rikuperimit dhe shpresojmë t'i kemi në fushë ndaj Teutës. Po ashtu, siç dihet për arsye dëmtimesh do na mungojnë Cicmil e Marku por ky nuk është justifikim. Ata që do të luajnë, duhet të japin më të mirën dhe të marrim fitoren e shumëpritur për ne. Objektivi gjithnjë ka qenë fitorja e çdo ndeshje dhe nga kjo nuk bën përjashtim as Teuta. Uroj dhe shpresoj shumë që këtë objektivi ta bëjmë realitet dhe të marrim këtë trepikëshin që do të na bënte shumë punë. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm sepse nëse sot jemi disi të qetë në renditje, një gabim do të na kushtonte shumë por unë kam besim tek skuadra që stërvis se do të jetë shumë serioze deri në fund të kampionatit"- ka thënë "timonieri" i kuqbluve para gazetarëve. I shfaqur në konferencën e sotme për shtyp përkrah portierit Selimaj, Cungu është ngacmuar duke i thënë se përderisa duhet fituar me Teutën, më mirë do kishte qenë që përkrah të kishte një sulmues, por numri 1 i pankinës shkodrane ka një mendim ndryshe kur thotë: "Patjetër që portieri është një pikë shumë e rëndësishme e skuadrës. Për më tepër që Selimaj në këto ndeshjet e fundit që është aktivizuar ka dhënë kontributin e tij maksimal për skuadrën që ajo të arrijë këto rezultate pozitive. Por kuptohet që për të arritur një rezultat të mirë, përgjegjësi kanë të gjithë, duke filluar nga unë, portieri e me radhë pastaj të gjithë. Nëse nuk funksionojmë si grup, do të jetë shumë e vështirë për ne, ndaj çdo lloj kundërshtari. Jam shumë i kënaqur me paraqitjet e Selimajt. është një djalë serioz që ka punuar me përkushtim gjatë gjithë periudhës, edhe kur nuk ka luajtur. Ka arritur të punojë me shumë seriozitet dhe ta fitojë vendin e titullarit dhe shpresojmë që të vazhdojë kështu"-ka thënë Cungu për të. Ndeshja e së dielës do të luhet në orën 17.00 në stadiumin "Loro Boriçi" dhe pritet të ketë interes edhe për tifozët shkodranë të cilët mendohet të mbushin shkallet e stadiumit me shume se çdo here tjetër këte radhe.